

RRJETI PËR ZHVILLIM RURAL I  
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

# e-buletini

**no.08** Janar-  
Qershor 2014



## PUBLIKON


Rrjeti për zhvillim rural i  
Republikës së Maqedonisë

"Kosta Veselinov" 3a, 1000 Skopje  
R. e Maqedonisë  
T: +389 (2) 3075 506  
F: +389 (2) 3075 503  
email: info@ruralnet.mk

[www.ruralnet.mk](http://www.ruralnet.mk)



## Në këtë numër...



### Fillime të aktiviteteve nga projekti:

LIDHJA E NJERËZVE ME NATYRËN - PËRFORCIM DHE RRJETËZIM I SHOQATAVE QYTETARE NË MAQEDONI ..... 3

Aktivitetet e zbatuara të “Eko Logik” ..... 5

Aktivitete të realizuara të “Etno - Beba” ..... 6

Aktivitete të realizuar nga SHMB “Ezerka” ..... 7

U hap zyra rajonale e RZR në Gostivar ..... 8

“Zhvillimi rural në Rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë - fuqizimi i aktorëve rural dhe LEADER qasja”  
organizuar në bashkëpunim me Grupin e përhershëm të punës për zhvillim rural në Ballkanin Perëndimor, PRE-PARE Partneriteti për Evropë Rurale, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, Rrjeti për Zhvillim Rural i Serbisë dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i Malit të Zi ..... 8

Manual për përdorimin e Rregullore për Zbatimin e LEADER si IPARD masë për zhvillim rural ..... 10

Janë promovuar pako këshillimore për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike ..... 11

Promovim të pakove këshillimore dhe shpërndarje të rezultateve dhe arritjeve në kuadër të projektit të USAID-it për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike ..... 12

Kuis për ndryshimet klimatike ..... 13

Mbledhja e katërt kuvendare e Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural ..... 14

Pjesëmarrje e Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural (RRBZHR) në Parlamentin e 13-të Rural Suedez ..... 15



Fillime të aktiviteteve nga projekti:

# LIDHJA E NJERËZVE ME NATYRËN - PËRFORCIM DHE RRJETËZIM I SHOQATAVE QYTETARE NË MAQEDONI



**M**e fillim nga marsi i vitit 2014, qendra ndërkombëtare për art dhe zhvillim të qëndrueshëm “Art Point - Gumno” me seli ne fshatin Slloeshticë si parter lokal i IPA projektit “Lidhja e njerëzve me natyrën - përforcimi dhe rrjetëzimi i shoqatave qytetare në Maqedoni” i koordinon aktivitetet që zbatohen në rajonin e malit Ilin-Plaken në kuadër të komunës Demir Hisar.

Projekti zbatohet në bashkëpunim me Plantlife International, nga Britania e Madhe dhe Shoqata Ekologjike e Maqedonisë nga Shkupi në rajonet: Osogovë, Mali Shar, Mali Ilin-Plaken dhe NP Pelister dhe qëllimi kryesor është kyçja e qytetarëve maqedonas si vullnetarë për mbrojtjen e natyrës; ndërmarrja e aksioneve që do të kontribuojnë për zbatimin e rregulloreve të BE-së për ruajtjen e rrjetit Natura 2000.

Më 22 maj 2014 ishte mbajtur evenimenti i parë në nivelin lokal që kishte për qëllim, me anë të punëtorive informative, të motivohen dhe rekrutohen vullnetarë për projektin. Në bazë të përvojave paraprake të “Art Point - Gumno”, grupi synues ishin nxënësit e shkollave fillore që me anë të aktiviteteve të tyre mund të transmetojnë mesazhet e projektit por edhe të shkëmbejnë përvoja me disa gjenerata në familjet e tyre (vëllezër/motra më të vegjël ose moshuar, prindër, gjyshër).





Ky aktivitet u zbatua në bashkëpunim me mësimdhënësit përgjegjës që japin biologji!

Në 3 punëtoritë që janë mbajtur në shkollat fillore komunale: “Goce Dellçev” në Demir Hisar dhe “Braça Milladinovci” në fshatin Zhvan, kanë marrë pjesë gjithsej 156 nxënës nga klasa e parë deri në klasën e tetë. Në fund të punëtorive, nxënësit morën për detyrë:

**Më të vegjlit, prej klasës 1 deri 4**

- Të zgjedhin një bimë mjekuese dhe të vizatojnë, ose
- Të bëjnë një punim nga letra (origami) në temë “Bimët e egra”

**Më të shuarit, prej klasës 5 deri 8**

- Të bëjnë një herbarium nga bimë të egra, ose
- Të shkruajnë ese, vjershë, gjëgjëzë ose punim letrar për ndonjë bimë të egër

Falë dedikimit dhe mbështetjes pa masë të personave përgjegjës në shkollën, veprat e lartpërmendura ishin mbledhur deri më 13 qershor. Të njëjtat do të jenë pjesë e ekspozitës e cila për herë të parë do të hapet gjatë manifestimit “Festimi i Pireut” në fshatin Silloeshticë (28 gusht 2014), ndërsa 3 veprat më të mira letrare do të shpërblehen dhe do të lexohen gjatë manifestimit.





# Aktivitetet e zbatuara të “Eko Logik”



**G**jatë periudhës prej janar deri në qershor 2014, OJQ Eko Logik në mënyrë aktive ka punuar në ngritjen e vetëdijes së qytetareve për mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe përforcimit të kapaciteteve të anëtarëve të saja.

Ekipi i Eko Logik në mënyrë të dedikuar ka punuar në realizimin e aktiviteteve në kuadër të fushatës “Fëmijët janë më të rëndësishëm se veturat”. Me qëllim të theksojnë sigurinë për fëmijët, kanë marrë iniciative për largimin e veturave nga zonat e këmbësoreve dhe oborreve të shkollave.

Në bashkëpunim me “Qendrën Autonome Kulturore Sociale, Shkup”, Eko Logik ka realizuar një sërë projekte të filmave dokumentar në tema lidhur me ndryshimet klimatike, mbrojtjen e mjedisit social dhe ngritjen e vetëdijes tek njerëzit për përmirësimin e rrethinës.

Anëtarët e ekipit “Eko Logik” kanë marrë pjesë në tema për transport të qëndrueshëm, që ishte zhvilluar në Spanjë. Në seminarin kanë qenë të pranishëm edhe aktivistë tjerë nga Maqedonia, si dhe nga Belgjika, Egjipti dhe Spanja.

Seminari tjetër ishte mbajtur në Danimarkë, ndërsa pjesëmarrje kanë marrë aktivistë nga gjithë Evropa të kanë përpunuar temën “Si të vendoset kontakt dhe si të komunikohet me të rinjtë për mjedisin tuaj”. Kjo temë është me interes të lartë për organizatën Eko Logik, në aspekt të aktiviteteve aktuale dhe të ardhshme me të cilën ekipi bën edukimin e fëmijëve dhe të rinjve në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe transportit të qëndrueshëm.





# Aktivitete të realizuara të “Etno - Beba”



Shoqata “Etno - Beba” ka marrë pjesë aktive në shumë konferenca dhe panaire ku kanë prezantuar punimet dhe kujtimet e tyre:

- “Konferenca për Sipërmarrje të Grave”, 10 prill 2014 në Shkup;
- Konferenca Ndërkombëtare “Fuqia e Grave” e organizuar me rastin e ditës botërore të sipërmarrjes për gra në Podgoricë, Mal të Zi, 15-18 maj;
- Panairi për sipërmarrje të grave, Podgoricë, Mal të Zi, 16 maj;
- Panairi për mobilie, Shkup, 6 – 17 janar;
- Panairi ndërkombëtar për punime shtëpiake dhe kujtime, Ulqinj, Mal të Zi, 24 – 28 qershor.

Kryetari i shoqatës, Gordana Mitrovska - Beba me vite të gjata punon në mënyrë aktive në fushën e promovimit të trashëgimisë tradicionale, si dhe në edukimin, përfshirë edhe motivimin e grave, të rinjve dhe grupeve të marginalizuara të viseve rurale, e udhëhequr nga motoja e saj “Mos të harrojmë amanetin e të parëve”, “Pasuria është në popullin dhe ajo vije nga tradita dhe historia” - shtoi ajo.

**S**hoqata “Etno - Beba” nga Kumanova, më tepër se 10 vite punon në mbrojtjen dhe afirmimin e trashëgimisë kulturore maqedonase, me anë të përpunimit dhe promovimit të veshjeve kombëtare, punimeve të dorës dhe kujtime. Në fillim të vitit 2014 ka filluar bashkëpunimin me Qendrën Multimediale Karpino nga Kumanova, që kanë organizuar bashkërisht manifestimin “Pivtijada 2014”, e cila tradicionalisht u mbajt për herën e dymbëdhjetë me radhë.

“Etno - Beba” me sukses ka realizuar projektin tremujor “Artizania nëpërmjet traditës dhe jetës bashkëkohore” në bashkëpunim me Shoqatën për Punime Artistike ARTI KRAFT Maqedoni, Qendrën për Rajonin Verilindor të Planifikimit, Fondacionin për Ndërmarrje të Vogla dhe të mesme nga Kumanova dhe Oda Rajonale e Artizanëve nga Kumanova. Projekti ishte mbështetur nga Ministria e Ekonomisë nëpërmjet Programit për Konkurrencë, Inovacione dhe Sipërmarrje, ndërsa ka përfshirë aktivitete lidhur me hartimin e artizanëve të vjetra dhe të zhdukura dhe inkurajimi i të rinjve nga mjediset rurale të fillojnë biznes me artizane.





# Aktivitete të realizuar nga SHMB “Ezerka”

**S**hoqata për Mundësi të Barabarta “Ezerka” nga Struga, në kuadër të aktiviteteve të saja, ka organizuar më tepër tribuna dhe takime gjatë periudhës prej janari deri në qershor 2014.

“Fenomeni i trafikimit me qenie njerëzore dhe si të mbroheni nga trafikimi me qenie njerëzore me theks të posaçëm në eksploatimin e punës në sektorin bujqësor” ishte tema e tribunës që është mbajtur në janar në f. Misleshevë.

Gjatë muajit shkurt ishin realizuar takime pune me fermerët e f. Moroishte, f. Misleshevë dhe f. Drasllajca në temën: “Si deri në subvencione” dhe “Praktika të mira bujqësore”. Gjatë tribunës fermerët i theksuan problemet me të cilat takohen gjatë punës së tyre, siç janë plehrat e shtrenjtë dhe materiali mbjellës dhe mungesa e plasmanit të prodhimit. Gjithashtu ata shprehën interes të organizimit të më tepër takimeve të ngjashme. Në tribinat kanë marrë pjesë përfaqësues të MPEU dhe deputetja nga Struga, Liljana Zaturaska.

Në mars, në f. Belçishte dhe f. Trebenishtë u mbajt tribinë në temën: “Trafikimi me qenie njerëzore, shkaqe dhe pasoja” me theks të veçantë në trafikimin në sektorin ndërtimor, bujqësor, tekstil dhe hotelier.

Në maj, në hapësirat e SHF “Murat Labunishta” në f. Labunishtë u mbajt tribinë me temën: “Bëhu grua e lumtur, mashtrroje kancerin”. Mes të pranishmëve kanë qenë edhe përfaqësues të Qendrës Mjekësore Strugë dhe ekipi i Ezerka.

Me fermerët e f. Borovec u mbajt tribinë në temë: “Njohja me programin për zhvillim rural dhe IPARD fondet”. Në tribinë ishte e pranishme edhe deputetja Liljana Zaturaska dhe përfaqësues të MBPEU të Strugës.





## U hap zyra rajonale e RZR në Gostivar

**P**ër të përmirësuar koordinimin dhe për të zgjeruar aktivitetet e saja në nivelin lokal, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë ka regjistruar zyrën rajonale në Gostivar.

Përveç zyrës qendrore në Shkup, RZR i RM-së deri më tani

ka pasur edhe dy zura tjera rajonale në Manastir dhe në Pehçevë.

Në këtë mënyrë, Rrjeti synon të animojë gjithë aktorët e zhvillimit rural në gjitha rajonet e vendit dhe të përmirësojë komunikimin në nivelin lokal.

## “Zhvillimi rural në Rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë - fuqizimi i aktorëve rural dhe LEADER qasja” organizuar në bashkëpunim me Grupin e përhershëm të punës për zhvillim rural në Ballkanin Perëndimor, PREPARE Partneriteti për Evropë Rurale, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, Rrjeti për Zhvillim Rural i Serbisë dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i Malit të Zi

**M**etoda LEADER është dëshmuar që është një sukses i madh në mobilizimin e aktorëve rural për bashkëpunim në nivelin lokal dhe nën-rajonar dhe në themelimin e relacioneve të mira mes administratave dhe aktorëve kryesore në zhvillimin rural. Rrjetet rurale kombëtare dhe evropiane, përfshirë edhe LEADER, PREPARE dhe tjerë kanë shkëmbyer përvojat e tyre pasi që me vite të shumta gjithnjë e më shumë janë të pranishëm dhe aktiv në rajon. Ata çdoherë kanë nënvizuar dhe kërkuar të promovojnë kuptimin e ndërsjelle dhe bashkëpunimin mes qeverive dhe aktorëve dhe partneritete mes sektorëve publik, privat dhe civil në nivelin nën-rajonar. Ata gjithashtu kanë theksuar dhe demonstruar, me anë të programeve të tyre, vlerën e shkëmbimit ndërkombëtar dhe kontakteve ballë-për-ballë mes gjithë palëve të përfshira dhe informacionet e freskëta që mund



të sigurohen nga shkëmbimi i përvojave dhe rrjetëzimi. Sipas përvojës së përshkruar më lartë, Komisioni Evropian ka



ofruar mbështetjen për një iniciativë stimuluese për të ndihmuar ata që janë përfshirë në përpilimin dhe zbatimin e programeve për zhvillim rural në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Më datën 31 mars deri më 2 prill kjo iniciativë ishte organizuar në formë të vizitës dyditëshe në teren ose “punëtori në udhëtim” dhe një konferencë njëditore në secilën prej tre vendeve të Ballkanit Perëndimor - Republikën e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë - që ishte plotësuar me një konferencë përmbyllëse të mbajtur në Bruksel. Kjo ishte bashkërisht e filluar nga Grupi i Përhershëm i Punës për Zhvillim Rural në Ballkanin Perëndimor (SWG), që përfaqëson qeveritë në rajon, dhe PREPARE Partneriteti për Evropë Rurale, me mbështetjen e TAIEK dhe Rrjeteve për Zhvillim Rural të Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi.

Ky eveniment kishte dy objektiva kryesore:

- Të rrit vetëdijen mes gjithë aktorëve për zhvillim rural, në veçanti grupet lokale të aksionit që do të formoheshin si pjesë e qasjes LEADER, për mundësitë dhe mënyrat e përfshirjes dhe bashkëpunimit në politikat relevante dhe vendimmarrje në nivelin kombëtar.
- Të tërheq vëmendjen e administratave kombëtare dhe vendimmarrësve për rëndësinë e krijimit të mënyrave të strukturara për përfshirje të aktorëve, veçanërisht aktorët lokal të viseve rurale, në përpilimin dhe zbatimin e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural.

## Pjesëmarrësit

Pjesëmarrësit e punëtorisë në udhëtim kanë qenë: përfaqësues të administratave publike dhe organizatat kryesore të aktorëve nga Turqia dhe secila nga vendet përfituese të IPA-s nga Ballkani Perëndimor; pjesëmarrësit ishin nga organizatat të ndryshme nga tre vendet nikoqire - Republika e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë; zyrtarë të Komisionit Evropian - DG AGRI dhe DG ENLARG; disa anëtarë ose zyrtarë të Parlamentit Evropian; për-

faqësues nga Partneriteti PREPARE dhe grupet e përhershme të punës për zhvillim rural në Ballkanin Perëndimor, Rrjetet për ZR nga tre vendet nikoqire; ekspertë nga vendet anëtare të BE-së, në cilësi të raportorëve ose këshilltarëve të grupeve nga Punëtorja në Udhëtim.

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë (RZR i RM-së) ka pasur detyrë të dizajnojë dhe të moderojë programin e vizitës në teren në Maqedoni dhe konferencën kombëtare, për të takuar me aktorët rural dhe të debatojnë për qasjes që kanë mundësuar pjesëmarrje efektive të aktorëve rural në proceset zhvillimore.


Vizitat në teren kanë mundësuar pjesëmarrësit të mbledhin informacione dhe të shohin shembuj praktik të bashkëpunimit të aktorëve, si aktorët rural mund të përfshihen në përpilimin dhe zbatimin e politikave për bujqësi dhe zhvillim rural veçanërisht duke përdorur qasjen LEADER në kuptimin më afatgjatë.

Konferenca Përmbyllëse ishte mbajtur më 8 prill në Bruksel dhe janë mbledhur përfaqësuesit e grupit të punëtorisë në udhëtim të Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Pas prezantimit të raporteve nga punëtorja në udhëtim, Komisari i BE-së për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, z. Dacian Ciolo kishte një hyrje dhe pastaj një diskutim në panel. Përfaqësuesit e ministrive të bujqësisë nga Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi dhe gjithashtu përfaqësues të rrjeteve për zhvillim rural të këtyre vendeve kanë bërë fjalimet e tyre. Kryetari i Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë prezantoi potencialet dhe mundësitë e rajoneve rurale dhe nevoja për bashkëpunim mes strukturave rrjetë (RZR i RM-së) dhe MPBEU-së për bashkimin e njerëzore për të shkëmbyer përvoja dhe njohuri, të informojnë dhe promovojnë aksionet e zhvillimit rural, të gjejnë partnerë për projekte dhe të bëjnë që njerëzit të ndjehen më të fuqishëm sepse janë pjesë e një njësie më të madhe. Me fjalë tjera, ka nevojë për zbatim të një fushate për të përhapur filozofinë, parimet dhe shtrirjen e metodës LEADER të bazuar në shtatë veçoritë e saja specifike për të arritur zhvillim të qëndrueshëm rural në gjithë territorin. Gjatë konferencës, RZR i RM-së morri lëvdatë për rolin e saj të jashtëzakonshëm në procesin e zhvillimit rural në Maqedoni.





# Manual për përdorimin e Rregullore për Zbatimin e LEADER si IPARD masë për zhvillim rural



**N**ë kuadër të projektit të USAID-it për Adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike, Rrjeti për Zhvillim Rural i RM-së ka përgatitur këtë manual për përdorim të rregulloreve për zbatimin e LEADER si IPARD masë për zhvillim rural.

Dy rregulloret e përgatitura nga MBPEU-së i përshkruajnë përmbajtjen dhe metodologjinë e përgatitjes së strategjive për zhvillim rural si dhe kushtet për regjistrim të Grupit Lokal Aksionar në GLA evidencën.

Ky manual do të paraqet një vegël të rëndësishme në procesin e informimit dhe trajnimit për LEADER metodologjinë si koncept udhëheqës për zhvillimin e mjediseve rurale.



# Janë promovuar pako këshillimore për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike

**N**ë kuadër të projektit të USAID-it për adaptim të bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike, profesorët e institutit të Bujqësisë dhe Fakultetit për Shkenca Bujqësore dhe Ushqim, gjatë dy viteve të kaluara në mënyrë intensive kanë punuar në testimin dhe demonstrimin e masave të ndryshme për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike. Rezultatet e fituara dhe përfitimet nga masat specifike adaptive, të cilat ishin të zbatuar dhe testuar në kopshtari, pemtari dhe vreshtari, kanë ndihmuar në përgatitjen e 9 broshurave të ndryshme dhe 4 video materialeve të cilat ishin xhiruar gjatë gjithë sezonit vegjetativ. Qëllimi i këtyre pakove këshillimore është të edukojnë publikun më të gjerë për efektet negative të ndryshimeve klimatike dhe mundësitë për adaptim të prodhimit të bujqësore dhe mbrojtje nga ndikimet e dëmshme.

Këto materiale janë shpërndarë nga fermerët, këshilltarët e ANZHB-së (Agjencia për Nxitjen dhe Zhvillimin e Bujqësisë), përfaqësues të ministrive, organizata të fermerëve dhe publiku më i gjerë, me anë të punëtorive, medie dhe internet faqet e RZR dhe ANZHB-së.





# Promovim të pakove këshillimore dhe shpërndarje të rezultateve dhe arritjeve ne kuadër të projektit të USAID-it për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike

**M**ë 21 shkurt 2014 në Negotinë dhe më 11 mars në Strumicë, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë ka organizuar punëtori të synuar për këshilltarët e ANZHB-së (Agjencia për Nx- itjen dhe Zhvillimin e Bujqësisë) dhe fermerë, me qëllim të prezantohen rezultatet dhe përfitimet e përdorimit të masave bujqësore për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike, të cilat ishin testuar dhe demonstruar gjatë sezonit të kaluar vegetativ, në kuadër të projektit të USAID për adaptim të bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike. Gjatë evenimenteve ishin promovuar pakot këshillimore që përshkruajnë dhe sqarojnë masa specifike dhe teknika për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, të cilat shpesh zbatuar dhe testuar në pemëtari, vreshtari dhe kopshtari. Në punëtorinë në Manastir kanë marrë pjesë mbi 60 pjesëmarrës të ANZHB-së dhe fermerë të pjesës perëndimore të Republikës së Maqedonisë (Manastir, Prilep, Resnjë, Ohër, Strugë, Demir Hisar dhe Krushevë). Gjithashtu, më tepër se 60 përfaqësues të ANZHB-së, FFRM-së (Federata e Fermerëve e Republikës së Maqedonisë) dhe fermerë individual kanë marrë pjesë në punëtorinë në Negotinë ndërsa në punëtorinë në Strumicë erdhën më tepër se 70 pjesëmarrës. Profesorët e Fakultetit



të Bujqësisë dhe ushqim dhe Institutit të Bujqësisë, që punojnë në projektin, i kanë prezantuar rezultatet nga hulumtimi për 18 muajt e fundit dhe kanë sqaruar përfitimet nga masat e ndryshme bujqësore që do të ndihmojnë fermerët të adaptojnë prodhimtarinë bujqësore ndaj ndryshimeve klimatike dhe të ruajnë rendimentin e tyre.





# Kuis për ndryshimet klimatike



**M**ë 9 maj, në shkollën e mesme bujqësore “Goce Dellçev” në Vallandovë, projekti i USAID-it për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike ka organizuar një Kuis për Ndryshimet Klimatike. Duke u ndërlidhur me suksesin e karvanit të vitit të kaluar për ndryshime klimatike, fushata e re ishte strukturuar si kuis ku grupi synues janë nxënësit e shkollave të mesme bujqësore. Ngjarja ishte zhvilluar si një disiplinë e veçantë, në kuadër të garës dyditore shtetërore të shkollave të mesme bujqësore në Maqedoni. Në kuisin kanë marrë pjesë nga 2 nxënës të gjitha 10 shkollave të mesme, mes të cilëve edhe nxënësit e SHMK “Dimitar Vllahov” nga Strumica, të cilët morën vendin e parë. Me anë të këtij aktiviteti, projekti i USAID-it kishte për qëllim të rrit vetëdijen mes të rinjve për ndikimin e ndryshimeve klimatike mbi bujqësinë dhe për nevojën e zbatimit të masave adaptive në vreshtarinë, kopshtarinë dhe pemëtarinë.





# Mbledhja e katërt kuvendare e Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural



**M**ë 9 maj, në Jahorinë, Bosnjë e Hercegovinë, Rrjeti Ballkanik për Zhvillim Rural (RRBZHR) ka zhvilluar mbledhjen e katër kuvendare, në kuadër të seancës së 29 të Kuvendit të Grupit të Përhershëm të Punës për Zhvillim Rural në Evropën Juglindore. Përveç anëtarëve të RRBZHR - rrjetet për zhvillim rural të Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi - në mbledhjen kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Rrjetit Kombëtar për Zhvillim Rural të Bullgarisë, Rrjeti i Kroacisë për Zhvillim Rural dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i Bosnjës dhe Hercegovinës.

Pas prezantimit të aktiviteteve aktuale nga ana e gjitha rrjeteve dhe përfaqësimit të Rrjetit Kombëtar për Zhvillim

Rural të Bullgarisë, ishte hapur diskutim edhe për kriteret dhe parimet e përfitimit të anëtarësisë në RRBZHR. Edhe një herë, anëtarët e rrjetit treguan interes për kyçe të gjitha vendeve ballkanike.

Përveç kësaj, kanë rënë dakord për tre mbledhje tjera të RRBZHR gjatë vitit 2014, në të cilat do të diskutohet dhe do të përfundohet strategjia e RRBZHR dhe plani i veprimit për periudhën 2014-2016. Në takimet pritet që të merret vendimi për kyçe të rrjeteve rurale të Bullgarisë, Kroacisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës, të cilat kanë shprehur dëshirë për tu bërë anëtare të RRBZHR.



# Pjesëmarrje e Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural (RRBZHR) në Parlamentin e 13-të Rural Suedez



**G**jatë periudhës prej 16 deri 18 maj, në vendin Gevleborg, Sandviken në Suedi, u zhvillua parlamenti i 13-të rural. Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë bashkë me anëtarë tjerë të Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural (RRBZHR) dhe Grupi i Përhershëm për Zhvillim Rural në Evropën Juglindore, kanë marrë pjesë në Parlamentin e 13-të Rural Suedez. RRBZHR-ja ishte prezantuar në parlamentin me anë të standës së vetë dhe materialeve promovuese si dhe me anë të pjesëmarrjes aktive gjatë pjesës punuese të eventimentit.

Në kuadër të parlamentit ishte organizuar një konferencë për shtyp me medie lokale në Suedi. Në emër të Grupit të Përhershëm për Zhvillim Rural në Evropën Juglindore menaxherja e projektit Bogdanka Leveska Gjorshoska e prezantoi zyrën kryesore/sekretariatit dhe Rrjetin Ballkanik për Zhvillim Rural. Në konferencën për shtyp ka marrë pjesë edhe Petar Gjorgievski, anëtar i RRBZHR, pranë mediave e prezantoi edhe Rrjetin për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë.

